



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 515 Prot.

Tiranë, më 21.01.2025

U D H Ë Z I M

Nr. 7, Datë 21.01.2025

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 30.06.2023 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË NJËVLERSHMËRISË SË DËFTESAVE DHE TË DIPLOMAVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË ARDHUR NGA JASHTË VENDIT”, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 52, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Orjana Osmani”,

U D H Ë Z O J:

**Neni 1**

1. Në udhëzimin nr. 13, datë 30.06.2023, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe të diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, i ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Shkronjat “a” dhe “c” të pikës 2, të kreut II ndryshojnë si më poshtë:

“a) *Formulari i aplikimit për dëftesat e përfundimit të arsimit bazë dhe dëftesa klase të arsimit parauniversitar plotësohen nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Parauniversitar (SMIP), drejtuar ZVAP.*

...

- c) *Formulari i aplikimit për diplomën e arsimit të mesëm të lartë plotësohet online në portalin unik qeveritar e-Albania, nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Parauniversitar (SMIP), drejtuar QSHA.*”
- b) Nën-pika “iii” e shkronjës “b”, nën-pika “iv” e shkronjës “d”, të pikës 2 dhe pika 3, të kreut II shfuqizohen.
- c) Në pikën 1, të kreut III togfjalëshi “...brenda 45 ditëve.” zëvendësohet me togfjalëshin “...brenda 30 ditëve.”
- d) Pika 1.2, e kreut III shfuqizohet.
- e) Pika 1.3, e kreut III ndryshon si më poshtë:
- “1.3 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, Komisioni i Njohjes së Dëftesave i kërkon aplikantit fillimisht plotësimin e dokumentacionit nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, brenda 15 ditëve nga momenti i aplikimit. Në rast të mosdepozitimit të plotësimeve brenda këtij afati, aplikimi refuzohet.”*
- f) Shkronja “c” e pikës 2, të kreut III ndryshon si më poshtë:
- “c) Depoziton në dosjen e aplikantit materialet shkresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera shkresore ose të printuara.”*
- g) Në pikën 1, të kreut IV togfjalëshi “...brenda 45 ditëve.” zëvendësohet me togfjalëshin “...brenda 30 ditëve.”
- h) Pika 1.6, e kreut IV ndryshon si më poshtë:
- “1.6 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, SNJD-ja i kërkon aplikantit fillimisht plotësimin e dokumentacionit nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, brenda 15 ditëve nga momenti i aplikimit. Në rast të mosdepozitimit të plotësimeve brenda këtij afati, aplikimi refuzohet dhe paraqitet aplikim i ri.”*
- i) Në pikën 1, të kreut VI togfjalëshi “...ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim kundër vendimit...” zëvendësohet me togfjalëshin “...ka të drejtë të bëjë ankim në portalit unik qeveritar “e-Albania” kundër vendimit...””.
- j) Pas pikës 3 të kreut IV shtohet pika 3/1 me përmbajtje si më poshtë:

*“3/1. Aplikimet dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga institucioni përgjegjës, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.”*

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe Komisioni i Njohjes së Dëftesave dhe Komisioni i Njohjes së Diplomave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**ZËVENDËSMINISTRI**

**ORJANA OSMANI**

